



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORIA RAJONALE E OFRIMIT FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK Fier**

Nr 168/Prot

Fier më, 16.05.2022

Lënda: Njoftim për Vend të lire pune.

DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSË

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

AGJENCISË KOMBËTARË TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE.

Në zbatim të ligjit nr 15/2019, "Për nxitjen e punësimit" ; të ligjit nr 15/2017 " Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr 554 datë 31.07.2019 " Për krijimin , mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombetare të punësimit dhe aftësive " ; të udhëzimit nr 14 datë 27.05.2021 " Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publik të arsimit dhe formimit profesional".

Ofruesi publik i AFP-së Drejtorisë Rajonale të Ofritit Formimit Profesional Publik Fier , ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin :

- Instruktor/e per kursin rrobaqepsi (Berat) 1 person

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të jetë kushte shëndetësorë që e lejojnë të kryejë detyrën
- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- d) Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) Të demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes, dhe komunikimit;
- f) Të demostroj aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a)Te kete diplomë të shkolles se mesme profesionale ose kualifikim profesional pas te mesem ne fushen/profesionin e kursit te formimit profesional , per te cilin po aplikon
- b)Te kete te pakten 3(tre)vjet eksperiencë pune në fushën në të cilën është kualifikuar
- c)Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

Dokumentet e aplikimit

1. Dosja e aplikantit e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë , duhet të përfshijë:
 - letërmotivimin për pozicionin;
 - jetëshkrimin (CV-në)
 - kartën e indentitetit
 - diplomë
 - librezë e punës
 - çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trainimet apo të tjera të përmendura në jetëshkrim;
 - certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
 - vërtetim i gjëndjes shëndetësore
 - vërtetimin e gjëndjes gjyqësore
 - vërtetim nga punëdhënësi i fundit , që ndaj tij nuk ka maaa disiplinore në fuqi;
 - rekomandim ose vlerësim pune nga punë dhënës të mëparshëm;
 - dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;
2. Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.
3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofrimit të AFP-së brenda datës...27.05.2022

DREJTORI

Aleksander Lalaj

